

UDHËZIM Nr. 36, datë 21.9.2020

**PËR NJË NDRYSHIM NË UDHËZIMIN NR. 5, DATË 30.1.2006
“PËR TATIMIN MBI TË ARDHURAT”, I NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në zbatim të nenit 40, të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, ministri i Financave dhe Ekonomisë,

UDHËZON:

Në udhëzimin nr. 5, datë 30.1.2006 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, bëhet ndryshimi i mëposhtëm:

1. Pika 5.7 “Zvogëlimet e kapitalit” zëvendësohet me këtë përmbajtje:

“5.7 Çdo zvogëlim kapitali, që nuk ka për qëllim zvogëlimin e humbjeve dhe që destinohet për shpërndarje ortakëve, do të konsiderohet dividend dhe do të tatóhet si i tillë, por vetëm në masën që zvogëlimi i kapitalit rrjedh nga fitimet e kapitalizuara të shoqërisë dhe jo nga kontributet në para ose në natyrë të pronarëve. Shtesat e kapitalit, kontributet në para ose në natyrë të ortakëve dhe zvogëlimi i kapitalit duhet të jenë në përputhje me rregullat dhe procedurat e ligjit “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**MINISTËR I FINANCAVE
DHE EKONOMISË**
Anila Denaj

Botuar ne F.Zyrtare 171/2020

Dale nga shtypi me 25.09.2020